



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 916 / Prot.

2

Patos, më 05/04 /2024



**MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro**

PROJEKTVENDIM

Nr. 30 datë 05/04 /2024

PËR

**MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIT DHE STATUTIT TË SHOQËRISË
SË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER NR. 916 PROT.,
DATË 03.04.2024**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të pikës “d” të nenit 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, VKB nr. 77, datë 13.10.2022 “Për dhënien e autorizimit Kryetares së Bashkisë Patos për fillimin e procedurave të negociimit me bashkitë e qarkut Fier, për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta për administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier, në bashkitë e qarkut Fier”, VKM nr. 8, datë 21.02.2023 “Për miratimin e marrveshjes dhe pjesmarrjen e bashkisë Patos në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të trajtimit të mbetjeve” i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos;

1. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier sh.a, nr. 916 prot., datë 03.04.2024, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi.

GRUPI I MENAXHIMIT

Sokol Meta

Ina Sauli

Mimoza Shtëmbari

Arben Semanjaku




Elda Goxhaj





Juela Shpata




Astrit Murati

Gazmira Pleasati

Adresa: Lagjja “Naftçari”, Rruga “Unaza”, Patos

Erion **Hatia** Orges **Golloshi** Alket **HALIMI** Eneo **Xhaferi**
  

Arben **Shpërdheja** Endrit **Çako** Armando **Gushi** Florian **Kita**
   

Blerina **LAÇI** Barie **Goxhaj** Nurkë **Hazizaj** Lindita **Pepa**
  

Adm. Njësia Administrative Zharrëz

Adm. Njësia Administrative Ruzhdije

Riza **Hoxha**

Agim **Mesutaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 916 / Prot.
2

Patos, më 25/10/2024

**RELACION
PËR**

**MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT TË SHOQËRISË
SË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER NR. 916 PROT.,
DATË 03.04.2024**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në Bashkinë Patos në vitin 2022 janë depozituar shkresat nr. 3414 prot., datë 26.04.2022; 3413/1 prot., datë 14.07.2022 dhe 3413/4 prot., datë 31.08.2022 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për marjen e masave lidhur me kontratën koncensionare të formës BOT “Për administrimin e impiantit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”, do fillojnë negociatat për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkta.

Me VKB nr. 77, datë 13.10.2022 u autorizua Kryetarja e bashkisë Patos për fillimin e procedurave të negociatave me bashkitë e qarkut Fier, për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta për administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier, në bashkitë e qarkut Fier”, pasë negociatave me bashkitë e qarkut Fier dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë u nënshkrua dhe marrëveshja për krijimin e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier nr.10096 prot., datë 14.11.2022.

Me VKM nr. 8, datë 21.02.2023 “Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e bashkisë Patos në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të trajtimit të mbetjeve” këshilli miratojë marrëveshjen në të cilën bashkia Patos kishte 7.03% të aksioneve në shoqërinë e trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier. Pas miratimit të marrëveshjes bashkitë e qarkut Fier vijuan procedurat ligjore për hartimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë në mbështetje të ligjit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për sa më sipër në mbështetje të pikës “d” të nenit 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos;

1. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier sh.a, nr. 916 prot., datë 03.04.2024, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e projektvendimit ngarkohet Dr. Financës dhe Shërbimi Social, Zv. Kryetarët e Bashkisë dhe Sektori Juridik.

Zv. Kryetare e Bashkisë

Ina **Sauli**

Dr. Financës dhe Shërbimit Social

Mimoza **Shtëmbari**

Juriste
Nurkë **Hazizaj**

KRYETARI
Fation Duro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 3304/Prot. Nr. 3011/Prot. Nr. 2459/Prot. Nr. 2806/Prot. Nr. 917/Prot. Nr. 1530/Prot.
Dt. 03/04/2024 Dt. 04/04/2024 Dt. 04/04/2024 Dt. 05/04/2024 Dt. 03/04/2024 Dt. 04/04/2024



AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë tregtare

“SHOQËRIA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER” sh.a.

Ne ortakët themelues, në cilësinë e personave juridikë publikë si më poshtë:

- **Bashkia Fier**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar), me seli në Fier, me adresë: Lagja “Kastriot, Rruga “Ramiz Aranitasi”, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Fier, Z.Armando Subashi.**
- **Bashkia Patos**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Patos, me adresë : “Shëtitorja Republika” Patos, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Patos Z.Fatjon Duraj.**
- **Bashkia Mallakastër**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Ballsh, me adresë : “Lagja 18 Prilli, 9308 Ballsh”, Mallakastër, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Mallakastër Z. Qerim Ismailaj.**
- **Bashkia Roskovec**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Roskovec, me adresë “Lagja nr 1, Qendër” Roskovec, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Roskovec, Zj. Majlinda Bufi.**
- **Bashkia Lushnjë**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) me seli në Lushnjë, me adresë , Lagja “Lagja Kongresi” Lushnjë, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Lushnjë, Zj. Eriselda Sefa.**



- **Bashkia Divjakë**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brënda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar), me seli në Divjakë, me adresë “Sheshi Santa Barbara” Divjakë, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Divjakë Z. Josif Gorrea**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr 9901 ,datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjin Nr 9723 , datë 03.05.2007 “Për rregjistrimin e biznesit “ i ndryshuar, në mbështetje të Marrëveshjes për krijimin e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier të lidhur midis Bashkisë Fier (nr 9851 prot, dt.11.11.2022), Bashkisë Lushnje (nr 10108 prot, dt.14.11.2022), Bashkisë Divjakë (nr 5947 prot, dt 11.11.2022), Bashkisë Patos (nr 2670/1 prot, dt.11.11.2022), Bashkisë Roskovec (nr 10096 prot, dt 14.11.2022), Bashkisë Mallakastër (nr.5618 prot, dt.14.11.2022) si dhe Autorizimeve të dhënë me Vendimin nr 81 dt.27.09.2022 të Këshillit Bashkiak Fier, Vendimin nr 77 datë 13.10.2022 të Këshillit Bashkiak Patos, Vendimin nr 52 datë 28.09.2022 të Këshillit Bashkiak Mallakastër, Vendimin nr 69 datë 30.09.2022 të Këshillit Bashkiak Roskovec, Vendimin nr 92 datë 25.10.2022, të Këshillit Bashkiak Lushnjë, Vendimin nr 49 datë 26.10.2022 të Këshillit Bashkiak Divjakë,

Vendosim si më poshtë vijon:

NENI 1


Forma juridike

1. Të themelojmë shoqërinë **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** sh.a në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë publike.
2. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** sh.a., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të shoqërisë

1. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie aksionare është që nëpërmjet fushës së ushtrimit të veprimtarisë, sipas objektit të përcaktuar të saj , të përmbushë funksionin vendor dhe shërbimin publik për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, si dhe të prodhojë e të shesë energji elektrike që gjenerohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor nënligjor në fuqi.
2. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.



NENI 3

Emri, logoja dhe vula e shoqërisë

1. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në qarkullimin juridiko-civil me emrin “**Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier**” (SKP-TM) sha. Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.
2. Logoja do të përmbajë fjalë nga emri shoqërisë.

NENI 4

Objekti I veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:
 - a) Trajtimi dhe përpunimi i mbetjeve urbane të grumbulluara nga zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Fier, Patos, Lushnje, Divjakë, Roskovec, Mallakastër, në përputhje me legjislacionin e mbetjeve, mjedisit dhe vetqeverisjes vendore. Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Fier;
 - b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
 - c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
 - d) Aktivitete të tjera në fushën e përpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit;
2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.
3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 5



Selia e shoqërisë dhe afati i veprimtarisë.

1. Selia e shoqërisë tregtare “**Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier**” sh.a do të jetë në Fier, me adresë : Njësia Administrative Mbrostar-Ura, ZK2636, Pasuria nr 1.
2. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar , duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000.000 lekë (dhjetë milionë) lekë.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 100 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 10.000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 100 aksione.



3. Aksionarët themelues të shoqërisë “Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier” sha.a zotërojnë në pronësi aksionet si më poshtë:

- Bashkia Fier, zotëron 50.78 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 51 (pesëdhjetë e një) numër aksionesh, me vlerë 5 100 000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë.
- Bashkia Lushnjë, zotëron 25 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 25 (njëzet e pesë) numër aksionesh, me vlerë 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
- Bashkia Patos, zotëron 7.03 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 7 (shtatë) numër aksionesh, me vlerë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
- Bashkia Roskovec, zotëron 5.47 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 5 (pesë) numër aksionesh, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Bashkia Divjakë, zotëron 7.03 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 7 (shtatë) numër aksionesh, me vlerë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
- Bashkia Mallakastër, zotëron 4.69 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 5 (pesë) numër aksionesh, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

NENI 7

Përbërja e kapitalit të shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionerëve themelues të kësaj shoqërie.
2. Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 10 000 000 lekë (dhjetë milionë) lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqërinë, me ofertë publike.
3. Një e katërta e vlerës nominale të aksioneve (kapitalit të shoqërisë), në shumën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë është depozituar nga Bashkia Fier në Degën e Thesarit Fier, në llogarinë “Shoqëri në Formim e Sipër”, në datën e nënshkrimit të këtij akti themelimi.
4. Pas regjistrimit të shoqërisë, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie, që do të çelet pranë Bankës RAIFFEISEN dega Fier. Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria “Fondi themeltar i aksionarit”, ku regjistrohet vlera e kapitalit të tij.

NENI 8

Organet drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon :

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve - organi me i lartë vendimarrës;
- Këshilli Mbikqyrës - organi i mbikqyrjes;
- Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.



NENI 9

Këshilli Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 deri në 21 antarë, të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht dhe administratorë të shoqërisë. Ata zgjidhen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marin pjesë.
2. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës, me përjashtim të aksionerit që zotëron paketën mazhoritare, i cili zgjedh 2 (dy) anëtarë.
3. Këshilli Mbikqyrës i parë i shoqërisë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:
 - Z. Andius Oлдashi, i datëlindjes 30.07.1976, identifikuar me ID nr H607730016J, përfaqësues i Bashkisë Fier
 - Znj. Eleni Gjikonđaj, e datëlindjes 01.02.1972, identifikuar me ID nr H25201041U, përfaqësues i Bashkisë Fier
 - Z.Evis Qyra, i datëlindjes 15.06.1986, identifikuar me ID nr I60615138O, përfaqësues i Bashkisë Lushnjë
 - Z.Eris Stambolliu, i datëlindjes 06.09.1989, identifikuar me ID nr I90906019P, përfaqësues i Bashkisë Divjakë
 - Z.Sokol Meta, i datëlindjes 19.06.1988, identifikuar me ID nr I80619095C, përfaqësues i Bashkisë Patos
 - Znj. Delina Hoxha, e datëlindjes 30.12.1990, identifikuar me ID nr J06230017K, përfaqësues i Bashkisë Roskovec
 - Z.Guri Nuhaj, i datëlindjes 12.02.1975, identifikuar me ID nr H50212080T, përfaqësues i Bashkisë Mallakastër
4. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë 3(tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 10



Administratori

1. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 3(tre) vjeçar.
2. Administratori i parë i shoqërisë tregtare **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** sha është Z. **ARJAN MUSA NDREU**, i datëlindjes 16.06.1962, me ID nr: **G20616011G**
3. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj, i cili ushtron këto të drejta të përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Eksperti Kontabël

1. Shoqëria tregtare **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** sha do të ketë një ekspert kontabël të autorizuar
2. Eksperti kontabël i autorizuar është Znj. Valentina Haxhi, e dtl. 27.05.1964, identifikuar me ID nr G4527050V, me nr licencë 37



Autorizimi për procedurat e themelimit

1. Ortakët themelues autorizojnë Kryetarin e Bashkisë Fier për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare “**Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier**” sh.a, sipas kërkesave të Ligjit nr 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

NENI 13

Të Tjera

1. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit
2. Aksionarët themelues mund të vendosin, me vullnetin e tyre, për pjesmarjen në shoqëri të tjera dhe mund të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkures me atë të shoqërisë tregtare “**sh.a** .
3. Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet , ato zgjidhen nga gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Aksionarët e shoqërisë:

1. **Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi,**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Armando Subashi

2. **Bashkia Lushnje, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Eriselda Sefa,**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Eriselda Sefa

3. **Bashkia Patos, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Fatjon Duro,**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Fatjon Duro

4. **Bashkia Roskovec, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Majlinda Bufi,**


Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Majlinda Bufi

5. **Bashkia Divjakë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Josif Gorrea,**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Josif Gorrea

6. **Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Qerim Ismailaj,**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë) Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË




Nr. 3303 Prot. Nr. 3010 Prot. Nr. 2438 Prot. Nr. 2805 Prot. Nr. 916 Prot. Nr. 1529 Prot.
Dt. 03/04/2024 Dt. 04/04/2024 Dt. 04/04/2024 Dt. 05/04/2024 Dt. 03/04/2024 Dt. 04/04/2024

STATUTI I SHOQËRISË

“SHOQËRIA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER” sh.a.

Sot, më datë 03.04.2024, me cilësinë e aksionarëve themelues, personat juridikë publikë si më poshtë:

- **Bashkia Fier**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar), me seli në Fier, me adresë: Lagja “Kastriot, Rruga “Ramiz Aranitasi”, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Fier, Z.Armando Subashi.**
- **Bashkia Patos**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Patos, me adresë : “Shëtitorja Republika” Patos, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Patos Z.Fatjon Duraj.**
- **Bashkia Mallakastër**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Ballsh, me adresë : “Lagja 18 Prilli, 9308 Ballsh”, Mallakastër, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Mallakastër Z. Qerim Ismailaj.**
- **Bashkia Roskovec**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në Roskovec, me adresë “Lagja nr 1, Qendër” Roskovec, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Roskovec, Zj. Majlinda Bufi.**
- **Bashkia Lushnjë**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) me seli në Lushnjë, me adresë, Lagja “Lagja Kongresi” Lushnjë, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Lushnjë, Zj. Eriselda Sefa.**
- **Bashkia Divjakë**, person juridik publik, njësi e vetëqeverisjes vendore, brenda territorit të Qarkut Fier, e krijuar bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) me seli në



Divjakë, me adresë "Sheshi Santa Barbara" Divjakë, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë Divjakë**
Z. Josif Gorrea

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin nr 9901 ,datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjin Nr 9723 , datë 03.05.2007 "Për rregjistrimin e biznesit " i ndryshuar, në mbështetje të Marrëveshjes për krijimin e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier të lidhur midis Bashkisë Fier (nr 9851 prot, dt.11.11.2022), Bashkisë Lushnje (nr 10108 prot, dt.14.11.2022), Bashkisë Divjakë (nr 5947 prot, dt 11.11.2022), Bashkisë Patos (nr 2670/1 prot, dt.11.11.2022), Bashkisë Roskovec (nr 10096 prot, dt 14.11.2022), Bashkisë Mallakastër (nr.5618 prot, dt.14.11.2022) si dhe Autorizimeve të dhënë me Vendimin nr 81 dt.27.09.2022 të Këshillit Bashkiak Fier, Vendimin nr 77 datë 13.10.2022 të Këshillit Bashkiak Patos, Vendimin nr 52 datë 28.09.2022 të Këshillit Bashkiak Mallakastër, Vendimin nr 69 datë 30.09.2022 të Këshillit Bashkiak Roskovec, Vendimin nr 92 datë 25.10.2022, të Këshillit Bashkiak Lushnjë, Vendimin nr 49 datë 26.10.2022 të Këshillit Bashkiak Divjakë,

Vendosim si më poshtë vijon:

KAPITULLI I

FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

NENI 1

Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionarëve themelues, të shprehur në aktin e themelimit, si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, themelohet shoqëria tregtare "**SHOQËRIA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER**" sh.a në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë publike, e cila do të funksionojë sipas dispozitave të Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti.

NENI 2

Emërtimi i Shoqërisë


Emërtimi i shoqërisë do të jetë shoqëria tregtare "**SHOQËRIA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER**" sh.a.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

a) Trajtimi dhe përpunimi i mbetjeve urbane të grumbulluara nga zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkiave Fier, Patos, Lushnje, Divjakë, Roskovec, Mallakastër, në përputhje me legjislacionin e mbetjeve, mjedisit dhe vetëqeverisjes vendore. Grumbullimi,



rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Fier:

- b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
 - c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
 - d) Aktivitete të tjera në fushën e përpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit;
2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.
 3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me licensat apo lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pacaktuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Aksioneri/ët e shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

KAPITULLI II


KAPITALI, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

NENI 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000.000 lekë (dhjetë milionë) lekë.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 100 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 10.000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 100 aksione.
3. Aksionarët themelues të shoqërisë **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** sh.a zotërojnë në pronësi aksionet si më poshtë:

- Bashkia Fier, zotëron 50.78 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 51 (pesëdhjetë e një) numër aksionesh, me vlerë 5 100 000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë.
- Bashkia Lushnjë, zotëron 25 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 25 (njëzet e pesë) numër aksionesh, me vlerë 2 500 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë.
- Bashkia Patos, zotëron 7.03 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 7 (shtatë) numër aksionesh, me vlerë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
- Bashkia Roskovec, zotëron 5.47 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 5 (pesë) numër aksionesh, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.



- Bashkia Divjakë, zotëron 7.03 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie , të barabartë me 7 (shtatë) numër aksionesh, me vlerë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
- Bashkia Mallakastër, zotëron 4.69 % të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj kompanie, të barabartë me 5 (pesë) numër aksionesh, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

NENI 6

Regjistri i aksioneve

1. Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga shoqëria, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.
2. Me kërkesën e aksionarit, shoqëria lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.
3. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve sipas ligjit.

NENI 7




Zmadhimi i kapitalit themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168-180 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të ligjit të mësipërm, zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila vendos me 3/4 (tre të katërtat) e votave të aksionarëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve, me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
3. Kapitali themeltar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.
4. Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

NENI 8

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë dhe në pajtim me dispozitat e neneve 181-186 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Zvogëlimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila vendos me 3/4 (tre të katërtat) e votave të aksionarëve, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total, personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.
4. Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të çënojë raportin e aksionarit para këtij zvogëlimi.



NENI 9

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

1. Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të shoqërisë, të destinuara për shpërndarje dhe tepricën e aktivitetit të mbetur, në rastin e likuidimit, në përpjestim me aksionet që zotëron.
2. Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Statut.
3. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
4. Aksionarët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjen e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.
5. Kur aksionet u kalojnë aksionarëve të rinj, këta ruajnë të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga aksionet.
6. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në Statutin e Shoqërisë dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQËRISË

SEKSIONI 1 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10



Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

1. Të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimit të shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme.
2. Çdo Asamble, e mbledhur rregullisht, përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionarët.

NENI 11

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e shoqërisë, si më poshtë:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) Ndryshimet në Statut;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës si dhe të Administratorit të shoqërisë;
 - d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar;
2. Miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorit, likujduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar;
3. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
4. Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
5. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;



- i) Pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j) Ndryshime në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- m) Çështje të tjera të parashikuara në Ligj dhe në Statut.

NENI 12

Organizimi i mbledhjeve të Asamblesë

1. Asambleja thirret nga Administratori, Këshilli Mbikqyrës ose Aksionerët të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
2. Asambleja thirret të paktën një herë në vit.
3. Asambleja mbledhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë territorit, e cila tregohet në njoftimin përkatës.
4. Thirrja e Asamblesë bëhet me anë të njoftimit me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike që i dërgohet aksionarëve së bashku me rendin e ditës, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblesë dhe rendin e ditës.
5. Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar kuorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë në të njëjtat forma si e para.
6. Njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

NENI 13


Rendi i ditës

1. Rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë, që njoftohet si më sipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e Statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
2. Administratori duhet t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkesë me shkrim, për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetën nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsive.
4. Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

NENI 14

Evidenca e pjesëmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet

1. Një aksioner mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksioner tjetër apo nga një person i tretë.




2. Bashkia, në cilësinë e aksionerit, si person juridik publik, përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga zyrtari i ngarkuar me vendim nga Këshilli i Bashkisë.
3. Gjatë mbledhjes së Asamblesë përgatitet lista e aksionerëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë nënshkruhet prej tyre.
4. Rregulloret përkatëse të mbledhjeve mund të parashikojnë se aksionarët që nuk janë të pranishëm kanë mundësinë e pjesëmarrjes në Asamble me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i aksionarëve.
5. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
6. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe aksionerëve që janë shprehur kundër. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
7. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
8. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Administratori është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë, për t'u konsultuar nga ana e aksionerëve të shoqërisë.

NENI 15 Kuorumi

1. Për çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja merr vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë më shumë se 50% të aksioneve, me të drejtë vote.
2. Për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionerët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shpresë apo me mjete të tjera elektronike.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të kërkuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

NENI 16 Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të aksionerëve që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për çështjet e tjera Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicën e votave të aksionerëve që marrin pjesë.
3. Çdo aksioner ka të drejtën e një vote.



NENI 17
Mënyra e votimit

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës apo Administratorit.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë kërkohet nga aksionarët që zotërojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

NENI 18
Vënia në dispozicion, të aksionarit, e dokumenteve dhe informacioneve


Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionarit/ëve, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja.
Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër, të caktuar nga Asambleja, dokumentet, që duhet t'u vihen në dispozicion aksionarit/ëve, i dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

SEKSIONI 2
KËSHILLI MBIKQYRËS

NENI 19
Përbërja dhe emërimi

1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 deri në 21 antarë, të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht dhe administratorë të shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marin pjesë.
2. Aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës, me përjashtim të aksionerit që zotëron paketën mazhoritare, i cili zgjedh 2 (dy) anëtarë.
3. Këshilli Mbikqyrës i parë i shoqërisë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

- Z. Andius Oldashi, i datëlindjes 30.07.1976, identifikuar me ID nr H607730016J, përfaqësues i Bashkisë Fier
- Znj. Eleni Gjickondaj, e datëlindjes 01.02.1972, identifikuar me ID nr H25201041E, përfaqësues i Bashkisë Fier
- Z.Evis Qyra, i datëlindjes 15.06.1986, identifikuar me ID nr I606151380, përfaqësues i Bashkisë Lushnjë
- Z.Eris Stambolliu, i datëlindjes 06.09.1989, identifikuar me ID nr I90905019P, përfaqësues i Bashkisë Divjakë
- Z.Sokë Meta, i datëlindjes 19.06.1988, identifikuar me ID nr I80619095C, përfaqësues i Bashkisë Patos
- Znj. Delina Hoxha, e datëlindjes 30.12.1990, identifikuar me ID nr J06230017K, përfaqësues i Bashkisë Roskovec



- Z.Guri Nuhaj, i datëlindjes 12.02.1975, identifikuar me ID nr H50212080T, përfaqësues i Bashkisë Mallakastër
4. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë 3 (tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.
 5. Këshilli Mbikqyrës, nga përbërja e tij, ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar, që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë gjithë periudhës së mandatit të dhënë. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës zgjidhet nga përfaqësuesit e aksionerit që zoteron paketën mazhoritare të aksioneve, ndërsa zvkryetari zgjidhet njëri prej përfaqësuesve të aksionerëve të tjerë.
 6. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zvkryetarit të Këshillit Mbikqyrës bëhet në mbledhjen e parë të tij.
 7. Përgjatë gjithë ushtrimit të detyrës, Këshilli mbikqyrës do të asistohet nga një sekretar, pa të drejtë vote, i cili do të jetë përgjegjës, për mbajtjen e protokollit të mbledhjeve, zbardhjen dhe administrimin e vendimeve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë, të Asamblesë së aksionerëve, mbajtjen e marrëdhënieve protokollare me Shoqërinë dhe Administratorin e saj, kryerjen e njoftimeve për anëtarët e këshillit mbikqyrës, për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit, si dhe mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme, kur kjo mbledhje thirret prej këshillit mbikqyrës. Sekretari do të kryejë cdo detyrë tjetër që do të ngarkohet nga Këshilli Mbikqyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 8. Masa e shpërblimit të sekretarit të Këshillit mbikqyrës, do të përcaktohet me Vendim të Këshillit, sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 20

Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës

1. Statuti ose Këshilli Mbikqyrës mund të përcaktojë hartimin dhe miratimin e rregulloreve për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimi i Këshillit për miratimin e kësaj rregulloreje duhet të jetë unanim.
2. Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga sekretari pa të drejtë vote, kryetari, dhe të paktën dy anëtarë pjesëmarrës në mbledhje. Procesverbali përmban vendimin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra.
3. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
4. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen si të vlefshme nëse në procesin e vendimarrjeve janë të pranishëm më shumë se 1/2 e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe, kur për një çështje ka parazim, vota e kryetarit mbizotëron për përcaktimin e shumicës dhe vlefshmërisë së vendimarrjes.
5. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës, mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo rregulloreve të Këshillit duke shprehur votën me shkresë, telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, që të mundur identifikimin e anëtarit.
6. Anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse Këshilli Mbikqyrës duhet të marrë një vendim për :
 - Bafërësimin e veprimtarisë së tij;



- faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- dhënien ose jo të përfitimeve të tjera.
- Cdo rast tjetër i përcaktuar në ligj, lidhur me trajtimin e konfliktit të interesit

NENI 21

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Kohëzgjatja e anëtarëve të parë të Këshillit Mbikqyrës është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhje.
2. Ata mund të shkarkohen nga detyra me vendim të Asamblesë së përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.

NENI 22

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës të shkarkojë një anëtar në rastet e shkeljes së detyrave të parashikuara në nenin 163 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

NENI 23


Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu dhe pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë.
2. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli Mbikqyrës në përputhje me leëgjislacionin në fuqi dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Shoqëria mbulon shpenzimet e nevojshme të anëtarëve të këshillit mbikqyrës, për ushtrimin e aktivitetit në interes të shoqërisë, sipas vendimit të marrë nga Këshilli për këtë qëllim.

NENI 24

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - a) Të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin, si dhe të përcaktojë kompetencat e tij;
 - b) Të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
 - c) Të japë direktiva për Administratorin, për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - d) Të kontrollojë dhe mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;
 - e) Të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë kompetencë e Asaj të Fundit, ti rekomandojë asaj vendime të nevojshme për tu marrë si dhe të zbatojë vendimet e Asamblese;
 - f) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;




- g) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë që vleresohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - h) Të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - i) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit dhe publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Administratori . Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për t'ju paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - j) Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël të kryhet të pakten një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Raporti i Këshillit Mbikqyrës të përmendur në pikën i), duhet të përmbajë dhe mendimin për raportin e auditimit ;
 - k) Të miratojë marrjen përsiper të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumentave të tjera të borxhit;
 - l) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - m) Të miratojë kalimin e aksioneve me propozim të administratorit të shoqërisë.
 - n) Të kryejë cdo veprim tjetër të përcaktuar në ligj dhe në statut
2. Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblesën e Përgjithshme në rastet si më poshtë:
- a) Kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim,
 - b) Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
 - c) Kur brenda dy viteve të para pas regjistrimit, shoqëria propozon të blejë pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë.
 - d) Për cdo rast tjetër, bazuar në legjislacionin në fuqi, që gjykon se është e nevojshme thirrja e Asamblesë së Përgjithshme për vendimarrje në kompetencë të saj

NENI 25

Personi juridik, anëtar i Këshillit Mbikqyrës

Një person juridik, që është aksioner i shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë individë (persona fizikë) të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i shoqërisë.



SEKSIONI 3
ADMINISTRATORI

NENI 26

1. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 3(tre) vjeçar. Administratori drejton e administron shoqërinë dhe merr vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare
2. Administratori i parë i shoqërisë tregtare **“Shoqëria e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier” sha** është **Z. ARJAN MUSA NDREU**, i datëlindjes 16.06.1962 , me **ID nr: G20616011G**
3. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 27


Emërimi dhe shkarkimi

1. Administratorë të shoqërisë mund të jenë një ose disa persona fizikë. Ata emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 (tre) vjet. Ata mund të rizgjidhen pas përfundimit të cdo mandati.
2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.
3. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të shkarkojë Administratorin e shoqërisë në çdo kohë.

NENI 28

Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
 - a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontaktues të shoqërisë;
 - d) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecnisë veprimtarisë, të cilat ia paraqet Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
 - e) Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - f) Të kryejë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore;
 - g) Të raportojë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
 - h) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



2. Administratori duhet të informojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raportimeve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim;
 - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;
 - Brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit, propozohet blerja nga një aksioner, e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë.

NENI 29

Përfaqësimi i shoqërisë

- Administratori përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët;
- Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre rregjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 30


Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorit

- Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen;
 - Të kryejnë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;
 - Të ushtrojnë kompetencat që ju jep ligji dhe Statuti;
 - Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
 - Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit të interesit, të pranishme apo të mundshme të interesave personale me ato të shoqërisë;
 - Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm;
 - Përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas kompetencave dhe tagrave që ju janë përcaktuar me ligj dhe në statut..

NENI 31

Mbikqyrja e veçantë

Aksionarët e cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në Statut apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, mund të kërkojnë Këshillit Mbikqyrës të kryejë mbikqyrje të veçantë për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.



KAPITULLI IV
EKSPERTET KONTABËL

NENI 32

Emërimi dhe shpërblimi

1. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
2. Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
3. Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria.
4. Shoqëria tregtare **“SHOQËRIA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER” sha** do të ketë 1 (një) ekspert kontabël.

NENI 33

Detyrat dhe të drejtat

1. Detyrat dhe të drejtat e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme mund t’u kërkojë ekspertëve kontabël të autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Me marrjen raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, Asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI V

LLOGARITË VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

NENI 34

Viti financiar

1. Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin.
2. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.


NENI 35

Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbase mbarës së raportit përfaqësuar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

NENI 36

Fitimet dhe fondet rezervë




1. Fitimet, që rezultojnë nga bilanci ushtrimor, do të shpërndahen, sipas një vendimi përkatës të Asamblesë, ndërmjet aksonarëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlerat e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5% që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit themeltar.
2. Aksionarët mund të vendosin sipas ligjit për një destinim të ndryshëm të fitimit të pashpërndarë. Me vendimin e miratimit të bilanci ushtrimor, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë t'i destinonjë fitimet që i takojnë ortakëve në formë dividendi për zmadhim të kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.

KAPITULLI VI MBARIMI, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

NENI 37

Mbarimi, likujdimi i shoqërisë

1. Shoqëria aksionere mbaron:
 - a) Kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
 - b) Kur merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
 - c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) Kur nuk ka kryer veprimtari për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
 - e) Me vendim gjykate;
2. Shoqëria aksionare likujdohet në dy mënyra: likujdimi i zakonshëm dhe likujdimi i thjeshtëzuar.
 - a) **Likujdimi i zakonshëm** kryhet nga likujduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
 - Në rast se Asambleja nuk merr vendim për caktimin e likujduesit ai zgjidhet nga gjykata.
 - Detyra e likujduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.
 - Në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, nëse likujduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, atëherë detyrohet ta pezullojnë procedurën e likujdimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
 - Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë, në çastin e hapjes së likujdimit dhe një bilanc përfundimtar, në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e një likujdimi zgjat më shumë se një vit, likujduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.
 - Bilanci miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.
 - Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likujduesi u shpërndan ortakëve aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ato kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.
 - Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likujduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likujdimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.
 - b) **Likujdimi i thjeshtëzuar**, mund të kryhet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionerët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjithë detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer dhe janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me



punëmarrësit. Administratorët njoftojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar, gjithashtu ata janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtë.

NENI 38

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe Aksionerit ose midis vet Aksionerëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatës kompetente, në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 39

1. Statuti hyn në fuqi pas miratimit dhe rregjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar)

Aksionerët e shoqërisë:

1. **Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Armando Subashi

2. **Bashkia Lushnje, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Eriselda Seja**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Eriselda Seja

3. **Bashkia Patos, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Fatjon Duro**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Fatjon Duro

4. **Bashkia Roskovec, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Majlinda Bufi**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Majlinda Bufi

5. **Bashkia Divjakë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Josif Gorrea**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Josif Gorrea

6. **Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Qerim Asmailaj**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

Qerim Asmailaj

